

2018

GJYKATA E
APELIT
GOSTIVAR



RAPORTI VJETOR

P Ë R M B A J T J A

I. TË DHËNA PËR PUNËN ME LËNDË	3
A) SEKTORI PENAL.....	6
B) SEKTORI CIVIL.....	8
C) LËNDË TË MBETURA.....	11
II. SEKTORI PËR PUNË PRAKTIKE DHE EVIDENCA.....	11
III. RAPORTI PËR VIZITAT E KRYERA TË GJYKATAVE NGA NIVELI ME I ULËT.....	11
IV. RAPORTI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN	11
V. RAPORTI MBI TEKNOLOGJINË INFORMATIVE	12
VI. RAPORTI MBI PAISJEN DHE MIRËMBAJTJEN E GJYKATËS	13
VII. RAPORTI MBI PLANIFIKIMIN DHE KRYERJEN E PROKURIMEVE PUBLIKE	13

I.TË DHËNA PËR PUNË ME LËNDË

Gjykata e Apelit në Gostivar si organ i pavarur shtetëror gjykon mbi bazë të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbi ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën, me çka siguron aplikimin e të drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Gjatë periudhës raportuese, gjykata me angazhimin maksimal profesional të të gjithë të punësuarve – gjykatësve, kuadrit profesional dhe personelit administrativ-teknik, mbetën të dedikuar në përpjekjet për kryerjen efikase dhe kualitative të detyrës gjyqësore, në korniza të kompetencave të saj me angazhimin maksimal dhe realizimin e programit për punë të vitit 2018.

Në këtë periudhë gjykata gjithsej lëndë në punë ka pasur 5.904, numër të cilin e përbëjnë 589 lëndë të përcjella si lëndë të pambaruara nga periudha raportuese e mëparshme dhe 5.315 lëndë të reja.

Domethënë, vëllimi i punës në krahasim me vitin e kaluar, kur numri i lëndëve shkoi deri në 6.006 u zvoglua për 102 lëndë.

Hyrja e lëndëve të reja në krahasim me vitin e kaluar, kur numri i lëndëve ishte 5.785 dhe i cili u zvoglua për 470 lëndë dhe gjithsej janë 5.315 lëndë.

Gjatë periudhës raportuese nga numri i përgjithshëm i lëndëve në punë, gjykata përfundoi 5.390 lëndë d.m.th 27 lëndë më pak në krahasim me vitin e kaluar.

Në lidhje me lëndët e pambaruara në fund të vitit raportues kanë ngelur 514 lëndë, që tregon rënie për 75 lëndë në raport me vitin e kaluar.

Sipas të dhënave me statistikë numri i lëndëve në periudhën raportuese në krahasim me vitin e mëparshëm në **sektorin penal** është konstatuar rritje e numrit të përgjithshëm të lëndëve në regjistrin “KSZH” dhe atë për 48 lëndë, regjistri “KZHM” mbetet i pandryshuar gjegjësisht 4 lëndë, ndërsa në regjistrat tjerë ka ulje të numrit të përgjithshëm të lëndëve në proces pune dhe atë në regjistrin “KZH” për 41 lëndë, në regjistrin “KR” për 5 lëndë dhe në regjistrin “PRKZH” për 408 lëndë në raport me vitin e mëparshëm. Në **sektorin civil** në periudhën raportuese ka rritje në regjistrin “GZH” për 323 lëndë, në regjistrin “ROZH” për 329 lëndë, ndërsa në regjistrin “TSZH” shënohet ulje prej 58 lëndëve dhe në regjistrin “R” për 16 lëndë më pak në raport me vitin e kaluar.

Në lëndët nga administrate gjyqësore në periudhën raportuese është konstatuar ulje prej 274 lëndëve.

Gjegjësisht në vitin 2018 tërësisht në punë ka pasur 5.904 lëndë nga të cilat 4.974 lëndë janë të mbuluara me normën e orientimit të përcaktuar nga Këshilli Gjyqësor, 57 lëndë të cilat nuk janë të mbuluara me normën e orientimit dhe 873 lëndë nga administrata gjyqësore.

1. Puna e lëndëve në nivelin e gjykatës

Regjistri	Lëndë të pazgjedhura në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Lëndë që janë duke u punuar përsëri	Gabimisht të regjistruara	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgjedhura
"KZH" lëndë penale të shkallës së dytë	39	391	0	0	430	392	38
"KZHM" lëndë penale të shkallës së dytë në procedure kundër të miturve	0	4	0	0	4	4	0
"KSZH" këshill penal i shkallës së dytë	0	170	0	0	170	168	2
"PRKZH" lëndë për kundërvajtje të shkallës së dytë	42	1128	0	0	1170	1162	8
"KR" regjisti për lëndë të ndryshme penale	0	25	0	0	25	25	0
"GZH" lëndë civile të shkallës së dytë	208	1551	0	0	1759	1428	331
"ROZH" lëndë të shkallës së dytë konteste të marrdhënieve të punës	237	944	0	0	1181	1076	105
"TSZH" lëndë të shkallës së dytë në konteste të tregtisë	63	197	0	0	260	230	30
"R" regjisti për lëndë të ndryshme civile	0	32	0	0	32	32	0
GJITHSEJ	589	4442	0	0	5031	4517	514

2. Administrata gjyqësore

Regjistri	Lëndë të pazgjedhura në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Gabimisht të regjistruara	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgjedhura
SU-regjistri për administratën gjyqësore	0	673	0	673	673	0
SU-DOV-regjistri konfidencial i administratës gjyqësore	0	9	0	9	9	0
SU-STR-DOV-regjistri konfidencial i rrjptë i administratës gjyqësore	0	0	0	0	0	0
UPP-regjistri për evidencë të parashtrësive dhe ankesave	0	77	0	77	77	0
IZZ-regjistri për largimin e gjykatësve ose kryetarit	0	110	0	110	110	0
SPI- regjistri për qasje të lirë deri te informatat	0	4	0	4	4	0
GJITHSEJ	0	873	0	873	873	0

Kualiteti i punës në nivel të gjykatës

Sipas të dhënave nga lëndët e kthyer nga Gjykata Supreme, gjykata ka mbajtur kualitetin e lartë të punës. Gjegjësisht nga 142 lëndë gjithsej të dërguara, të pranuar janë 199 lëndë nga të cilat 125 vendime janë të vërtetuara ose 62,81%, 13 vendime janë ndryshuar ose 6,53%, 25 vendime janë prishur ose 12,56%, 35 vendime janë hedhur poshtë ose 17,59% dhe 1 vendim është zgjedhur në mënyrë tjetër ose 0,50%.

Lëndë të dërguara	Lëndë të pranuar	Të vërtetuara		Të anuluar		Të ndryshuar		Të hedhura poshtë		Në mënyrë tjetër	
142	199	125	62,81%	25	12,56%	13	6,53%	35	17,59%	1	0,50%

A) SEKTORI PENAL

Në sektorin penal në pajtim me orarin e punës së gjykatësve në Gjykatën e Apelit në Gostivar për vitin 2018, kanë vepruar pesë (5) këshilla penal nga të cilët dy këshilla veprojnë në zgjedhjen e lëndëve të regjistrit “KZH”- lëndë penale të shkallës së dytë dhe nga regjistri “PRKZH” - lëndë për kundërvajtje të shkallës së dytë ndërsa një këshill penal për zgjedhje të lëndëve nga regjistri “KZHM”, në pajtim me Ligjin për të drejtat e të miturve dhe këshill i posaçëm i cili vepron vetëm me lëndët penale të regjistruara me regjistrin “KSZH” dhe “KR”, një këshill penal me pesë (5) gjykatës për vepra penale me të cilat me ligj është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje deri më 15 vite ose me burg të përjetshëm.

Në sektorin penal në periudhën raportuese tërësisht në punë ka pasur 1.799 lëndë nga të cilat 81 lëndë janë përcjellur si të pazgjedhura nga viti i mëparshëm, ndërsa 1.718 lëndë janë lëndë të reja të pranuar, me çka gjykata tërësisht ka zgjedhur 1.751 lëndë, ndërsa në fundin e vitit kanë ngelur të pazgjedhura 48 lëndë që transferohen në vitin e ardhshëm.

Në raport me vitin e mëparshëm kur gjykata në punë ka pasur gjithsej 2.205 lëndë, në periudhën raportuese fushëveprimi i punës u zvoglua për 406 lëndë, për shkak të fluksit të zvogluar që është për 388 lëndë më pak në krahasim me vitin e kaluar kur janë pranuar 2.106 lëndë.

Numri i lëndëve të zgjedhura në periudhën raportuese është zvogluar për 373 lëndë në krahasim me vitin e kaluar ku janë zgjedhur 2.124 lëndë. Në raport me vitin e kaluar ku kanë ngelur 81 lëndë të pazgjedhura, në periudhën raportuese ky numër u zvoglua për 33 lëndë dhe gjithsej numri i lëndëve është 48.

Në periudhën raportuese në gjykatë në regjistrin “KZH” gjithsej ka pasur 430 lëndë, nga të cilat 39 lëndë janë transferuar si të pazgjedhura nga viti i kaluar dhe 391 lëndë të reja janë pranuar, me çka gjykata gjithsej ka zgjedhur 392 lëndë, ndërsa në fundin e vitit të pazgjedhura kanë ngelur 38 lëndë të cilat transferohen në vitin e ardhshëm.

Në regjistrin “KZHM” lëndë penale në procedurë kundër të miturve, të regjistruara janë 4 lëndë, të cilat janë zgjedhur gjatë periudhës raportuese.

Në regjistrin “KSZH” të regjistruara janë 170 lëndë, nga të cilat janë zgjedhur 168 lëndë ndërsa 2 lëndë janë transferuar në vitin e ardhshëm si të pazgjedhura.

Në regjistrin “PRKZH” lëndë për kundërvajtje janë regjistruar 1.128 lëndë, duke marrë parasysh edhe 42 lëndët nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka pasur 1.170 lëndë nga të cilat në periudhën raportuese janë zgjedhur 1.162 lëndë, ndërsa kanë ngelur të pazgjedhura 8 lëndë.

Në regjistrin “KP” gjithsej në punë ka pasur 25 lëndë të cilat në periudhën raportuese të gjitha janë zgjedhur.

Gjendja në raport me kohëzgjatjen e procedurës është siç vijon:

- Deri një (1) muaj janë zgjedhur 1038 lëndë,
- Prej një deri tre (1-3) muaj janë zgjedhur 497 lëndë,
- Nga tre deri gjashtë (3-6) muaj janë zgjedhur 193 lëndë,
- Mbi gjashtë (6) muaj janë zgjedhur 23 lëndë.

1. Puna e lëndëve në nivelin e sektorit penal

Regjistri	Lëndë të pazgjedhura në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Lëndë që janë duke u punuar përsëri	Gabimisht të regjistruara	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgjedhura
KZH	39	391	0	0	430	392	38
KZHM	0	4	0	0	4	4	0
KSZH	0	170	0	0	170	168	2
PRKZH	42	1128	0	0	1170	1162	8
KR	0	25	0	0	25	25	0
GJITHSEJ	81	1718	0	0	1799	1751	48

Kualiteti i punës në Sektorin Penal

Sektorin Penal në Gjykatën e Apelit në Gostivar në periudhën raportuese sipas të dhënave nga lëndët e kthyer nga Gjykata Supreme, ka mbajtur nivelin e lartë të punës.

Në periudhën raportuese gjithsej të dërguara janë 40 lëndë, ndërsa nga ana e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë kthyer 46 vendime, nga të cilat 30 vendime janë vërtetuar, gjegjësisht 65,22% , 11 vendime janë anuluar, gjegjësisht 23,91%, 1 vendim është ndryshuar, gjegjësisht 2,17% dhe 4 vendime janë hedhur poshtë, gjegjësisht 8,70%.

▪ Në regjistrin “KZH” janë pranuar 46 vendime, nga të cilët 30 janë vërtetuar (65,22% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 7,65% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 11 vendime janë anuluar (23,91% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 2,81% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 1 vendim është ndryshuar (2,17% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 0,26% nga gjithsej lëndë të zgjedhura) dhe 4 vendime janë hedhur poshtë (8,70% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 1,02% nga gjithsej lëndë të zgjedhura).

Regjistri	Lëndë të dërguara	Lëndë të pranuar	Të vërtetuara		Të anuluar		Të ndryshuara		Të hedhura poshtë	
KZH	40	46	30	65,22%	11	23,91%	1	2,17%	4	8,70%
KZHM	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
KSZH	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PRKZH	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
KR	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	40	46	30	65,22%	11	23,91%	1	2,17%	4	8,70%

B)SEKTORI CIVIL

Në sektorin civil në pajtim me orarin e punës të gjykatësve dhe të punësuarve të tjerë për vitin 2018 kanë vepruar dy këshilla që veprojnë sipas lëndëve të regjistruara në regjistrin “GZH” - lëndë civile të shkallës së dytë dhe këshilli i tretë, i cili vepron sipas lëndëve të kontesteve tregtare dhe të marrëdhënieve të punës në regjistrin “TSZH” lëndë të shkallës së dytë me konteste tregtare dhe regjistri “ROZH” lëndë nga konteste të marrëdhënieve të punës. Në korniza të sektorit civil ekziston edhe këshill i veçantë që punon me lëndët P5 – vërtetim të përgjegjësive civile për fyerje dhe shpifje, dhe poashtu ekziston edhe këshill i veçantë që punon lëndët e lidhura me falimentim.

Në raport me vitin e kaluar në sektorin civil, kur Gjyqi në punë ka pasur gjithsej 2.654 lëndë, fluksi i punës në periudhën raportuese është rritur për 578 lëndë dhe shuma gjithsej është 3.232 lëndë. Fluksi në periudhën raportuese është rritur për 192 lëndë në raport me vitin e kaluar, gjegjësisht janë pranuar 2.724 lëndë. Numri i lëndëve të zgjedhura në periudhën raportuese është rritur për 620 lëndë në raport me vitin e kaluar kur ishin zgjedhur 2.146 lëndë dhe gjithsej janë 2.766 lëndë. Numri i lëndëve të pazgjedhura në fundvit është ulur për 42 lëndë në raport me vitin e kaluar dhe gjithsej janë 466 lëndë.

Gjatë periudhës raportuese në gjykatë gjithsej në punë ka pasur 1.759 lëndë civile, nga të cilat 208 lëndë janë transferuar si të pazgjedhura nga viti i kaluar dhe 1.551 janë pranuar të reja, me çka Gjyqi gjithsej ka zgjedhur 1.428 lëndë, ndërsa në fundvit të pazgjedhura kanë mbetur 331 lëndë që janë transferuar në vitin e ardhshëm.

Në regjistrin “TSZH” konteste tregtare, janë regjistruar 197 lëndë, dhe duke marrë parasysh dhe 63 lëndët e pazgjedhura nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka pasur 260 lëndë, nga të cilat janë zgjedhur 230 lëndë, ndërsa të pazgjedhura kanë ngelur edhe 30 lëndë.

Në regjistrin “ROZH” konteste të marrëdhënieve të punës janë regjistruar 944 lëndë, duke marrë parasysh edhe 237 lëndë të pazgjedhura nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka pasur 1.181 lëndë nga të cilat në periudhën raportuese janë zgjedhur 1.076 lëndë, ndërsa të pazgjedhura kanë mbetur 105 lëndë.

Në regjistrin “R” lëndë të ndryshme civile janë pranuar 32 lëndë dhe të njejtat janë zgjedhur, me çka nuk ka mbetje për vitin e ardhshëm.

Këshilli i cili punon në vërtetimin e përgjegjesisë civile për fyerje dhe shpifje në periudhën raportuese ka pasur 18 lëndë , nga të cilët 14 janë zgjedhur, ndërsa 4 lëndë janë transferuar për vitin e ardhshëm. Ndërsa këshilli që punon lëndët e lidhura me falimentim gjithsej në vitin 2018 në punë ka pasur 34 lëndë nga të cilët 29 janë zgjedhur, ndërsa 5 lëndë kanë mbetur të pazgjedhura.

Gjendja në raport me kohëzgjatjen e procedurës është siç vijon:

- Deri një (1) janë zgjedhur 606 lëndë,
- Prej një deri tre (1-3) muaj janë zgjedhur 906 lëndë,
- Prej tre deri gjashtë (3-6) muaj janë zgjedhur 982 lëndë,
- Mbi gjashtë (6) muaj janë zgjedhur 272 lëndë.

1. Puna e lëndëve në nivelin e sektorit civil

Regjistri	Lëndë të pazgjedhura në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Lëndë që punohen sërish	Gabimisht të regjistruara	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgjedhura
GZH	208	1551	0	0	1759	1428	331
ROZH	237	944	0	0	1181	1076	105
TSZH	63	197	0	0	260	230	30
R	0	32	0	0	32	32	0
GJITHSEJ	508	2724	0	0	3232	2766	466

Kualiteti i punës në Sektorin Civil

Sektorin Civil në Gjykatën e Apelit në Gostivar në periudhën raportuese sipas të dhënave nga lëndët e kthyer nga Gjykata Supreme, ka mbajtur nivelin e lartë të punës.

Në periudhën raportuese gjithsej të dërguara janë 102 lëndë, ndërsa nga ana e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjithsej janë pranuar 153 vendime, nga të cilat 95 vendime janë

vërtetuar gjegjësisht 62,10%, 12 vendime janë ndryshuar gjegjësisht 7,84%, 14 vendime janë anuluar, gjegjësisht 9,15%, 31 vendime janë hedhur poshtë, gjegjësisht 20,26% dhe 1 vendim është zgjedhur në mënyrë tjetër, gjegjësisht 0,65%.

▪ Në regjistrin “GZH” janë dërguar 66 lëndë, nga të cilët janë pranuar 95 vendime dhe atë 67 të vërtetuara (70,53% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 4,70% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 7 lëndë janë ndryshuar (7,37% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 0,50% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 5 vendime janë anuluar (5,26% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 0,35% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), dhe 16 lëndë janë hedhur poshtë (16,84% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 1,12% nga gjithsej lëndë të zgjedhura).

▪ Në regjistrin “TSZH” janë dërguar 19 lëndë, ndërsa janë pranuar 34 vendime, nga të cilët 17 vendime janë vërtetuar (50% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 7,39% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 3 vendime janë ndryshuar (8,83% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik gjegjësisht 1,30% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 8 vendime janë anuluar (25,53% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 3,48% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), dhe 6 vendime janë hedhur poshtë (17,65% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 2,61% nga gjithsej lëndë të zgjedhura).

▪ Në regjistrin “ROZH” janë dërguar 17 lëndë, ndërsa janë pranuar 24 vendime, nga të cilët 11 vendime janë vërtetuar (45,83% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 1,02% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 2 vendime janë ndryshuar (8,83% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 1,19% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 1 vendim është anuluar (4,17% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 0,10% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 9 vendime janë hedhur poshtë (37,5% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 0,84% nga gjithsej lëndë të zgjedhura) dhe 1 vendim është zgjedhur në mënyrë tjetër (4,17% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 0,10% nga gjithsej lëndë të zgjedhura).

Regjistri	Lëndë të dërguara	Lëndë të pranuar	Të vërtetuara		Të ndryshuara		Të anuluar		Të hedhura poshtë		Të zgjedhura në mënyrë tjetër	
			Numri	Përqindje	Numri	Përqindje	Numri	Përqindje	Numri	Përqindje	Numri	Përqindje
GZH	66	95	67	70,53%	7	7,37%	5	5,26%	16	16,84%	0	0
TSZH	19	34	17	50,00%	3	8,83%	8	23,53%	6	17,65%	0	0
ROZH	17	24	11	45,83%	2	8,33%	1	4,17%	9	37,5%	1	4,17%
R	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	102	153	95	62,10%	12	7,84%	14	9,15%	31	20,26%	1	4,17%

C) MBETJA E LËNDËVE DHE LËNDËT E VJETRA

Numri i lëndëve të mbetura në fundin e vitit 2017 është 589 lëndë, ndërsa në fundin e vitit 2018 është 514 lëndë që do të thotë se mbetja është ulur për 75 lëndë.

Mbetja e lëndëve të vjetra në fundin e vitit 2017 ishte 11 lëndë, i cili numër është ulur për 8 lëndë dhe në fundin e vitit 2018 ka 3 lëndë dhe atë 2 nga regjistri “GZH” dhe 1 nga regjistri “TSZH”.

II. SEKTORI PËR PUNË PRAKTIKE DHE EVIDENCA

Në pajtim me autorizimet e parapara me Rregulloren Gjyqësore (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.66/2013) sektori për punë praktike, sjell plan vjetor për punë në sektorin e punës praktike në Gjykatën e Apelit në Gostivar për vitin 2018.

- Gjatë vitit 2018 janë kryer përgaditje për sjelljen e qëndrimeve ligjore për pyetjet kontestuese nga Sektori Penal dhe Civil, të cilat diskutohen në mbledhjet me tryeza të rumbullakëta në nivel të katër (4) Gjykatave të Apelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat tryeza të rumbullakëta organizohen dy herë në vit.
- Është kryer përgaditja dhe përzgjedhja e vendimeve të marra sipas sekotëve penal dhe civil për Bilten nr.3, i cili do të publikohet në fillim të vitit 2019.

III. RAPORT PËR VIZITAT E KRYERA NË GJYKATAT E NIVELIT MË TË ULËT

Bazuar në Metodologjinë për kryerjen e vizitave të punës në rajonin e Gjykatës së Apelit Gostivar dhe orarin e percaktuar të vizitave të punës në gjykatat themelore nga ky rajon për vitin 2018, gjyqi në periudhën raportuese ka kryer dy vizita pune, njëra vizitë punë u organizua dhe u krye gjatë pjesës së parë të vitit 2018 në muajt Prill dhe Maj 2018 dhe vizita e dytë u organizua dhe u krye gjatë pjesës së dytë të vitit 2018 në muajt Tetor dhe Nëntor 2018.

Për vizitat e kryera dhe marrja e masave gjatë vizitave, çdo gjykatës ka përgaditur raport në afat prej 8 ditësh nga vizita e kryer, i cili është dorëzuar deri te Gjykatat Themelore, Këshilli Gjyqësor, Gjyqi Suprem i Republikës së Maqedonisë Veriore dhe Ministria e drejtësisë.

IV. RAPORT PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Në pajtim me nenin 4 dhe nenin 12 të Ligjit për qasje të lirë deri te informatat publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.13/06, nr.86/08, nr.6/10, nr.42/14, nr.148/15, nr.55/16 dhe nr.64/18) personat juridik dhe fizik të vendit dhe të huaj kanë të drejtë për qasje të lirë deri te informatat e karakterit publik, që janë në lidhje me punën e kësaj gjykate. Në raportin e vitit 2018 në pajtim me ligjin e cituar më lartë, deri te kjo gjykatë janë dorëzuar gjithsej tre (3) kërkesa të cilat kanë marrë përgjigje në afatin e caktuar me ligj. Kundër procesverbaleve të sjella deri te kjo gjykatë, të cilat kanë marrë përgjigje për informacionin e kërkuar të natyrës publike nuk është parashtruar asnjë ankesë deri te Komisioni për mbrojtjen e të drejtës së qasjes së lirë deri te informacionet e karakterit publik.

Asnjë ankesë nuk është dorëzuar në zyrën për marrëdhënie me publikun. Në lidhje me vendimet e publikuara në faqen e internetit për periudhën raportuese, janë publikuar gjithsej 4.324 vendime anonime.

V. RAPORTI PËR TEKNOLOGJINË INFORMATIVE

Funksionimi i gjyqit në periudhën raportuese në aspektin e teknologjisë informative u zhvillua pa pengesa, si dhe në pjesën e përdorimit të Sistemit informatik automatik për menaxhimin e lëndëve gjyqësore (AKMIS).

Sistemi AKMIS nga ana e të punësuarve përdoret plotësisht në të gjitha segmentet e punës. Çdo lëndë gjegjësisht çdo akt rregullisht regjistrohet në dosjet elektronike të lëndëve dhe përpunohen në përputhje me rrethanat. Të gjitha raportet e duhura mujore, tre mujore dhe vjetore përpunohen në mënyrë elektronike.

Në gjykatë ka një dhomë gjykimi ku është instaluar paisje për regjistrim të tonit të zërit gjatë seancave në pajtim me Ligjin për procedurë kontestimore. Kjo paisje rregullisht përdoret nga ana e gjykatësve nga sektori civil, tregtar dhe sektori për marrëdhëniet e punës duke ndjekur rregullat për regjistrim të tonit të zërit. Por, duke marrë parasysh domethënien e këtij sistemi dhe përdorimin e suksesshëm në të ardhmen duhet të sigurohet mirëmbajtje dhe përmirësim i sistemit për shkak të paisjeve tashmë të konsumuara.

Në lidhje me dërgesat elektronike, në këtë periudhë raportuese nuk janë paraqitur probleme dhe procedura e dërgesave elektronike po kryhet pa pengesa, vetëm drejt atyre avokatëve që janë regjistruar në portalin e dërgesave elektronike.

Anonimiteti i vendimeve të Gjykatës po kryhet pa pengesa dhe në periudhën raportuese janë publikuar gjithsej 4.324 vendime anonime. Gjithashtu web portali i Gjykatës rregullisht përditësohet me raporte mujore, tre mujore dhe vjetore, si dhe me të gjitha informacionet e duhura për palët. Gjykata e Apelit në Gostivar gjithashtu ndjek punën e Gjykatave Themelore në rajonin që mbulon në lidhje me dërgesat elektronike, regjistrimin e tonit të zërit dhe procesin e anonimitetit dhe publikimit të vendimeve në baza javore.

Sa i përket harduerit të gjithë kompjuterat janë të mbrojtur nga një antivirus i licencuar. Përgjatë vitit 2018 është kryer prokurim i 10 kompjuterëve me çka deri diku janë përmbushur kërkesat e Gjyqit, edhe pse 40% e të punësuarve punojnë me sistemin operativ Windows XP që nuk është i mbështetur nga Microsoft dhe kërkon zvendësim.

Puna me sistemin ABMS kryhet pa pengesa, përmirësohet në kohën e duhur dhe përgjatë periudhës raportuese nuk janë paraqitur probleme.

Rritja dhe modifikimi i teknologjisë informative kërkon që të gjithë të punësuarit të përmirësohen dhe perfeksionohen vazhdimisht.

VI. RAPORT MBI PAISJEN DHE MIRËMBAJTJEN E NDËRTESES SË GJYQIT

Ndërtesa e Gjykatës së Apelit gjendet në Rr. “Zhivko Brajkovski” nr.1 në Gostivar. Në ndërtesë janë të vendosur Prokuroria e Lartë Publike Gostivar, Prokuroria Themelore Publike Gostivar si dhe Gjykata Themelore Gostivar, me çka po ballafaqohemi me numër të pamjaftueshëm të kapacitetit hapsinor

Gjatë vitit 2018 është kryer rikonstruim i hapsirave në gjykatë me çka janë zvogluar të njejtat hapsira, me qëllim që të sigurohen kushte për punë pa pengesa dhe kryerja e detyrave të përditshme. Me këtë rikonstruim janë fituar 7 hapsira të reja për punë që deri diku kanë përbushur nevojat në raport me kapacitetin e hapsirave.

VII. RAPORT MBI PLANIFIKIMIN DHE PROKURIMET PUBLIKE TË KRYERA

Në vitin 2018 nëpërmjet prokurimeve publike, në pajtim me Planin për Prokurime Publike në vitin 2018, në Gjykatë janë planifikuar që nga mjetet e buxhetit të Këshillit gjyqësor për vitin 2018 të realizohen prokurimet e përmendura më poshtë:

- prokurim i materialeve për AOP tonerëve dhe aparati i fotokopjes,
- prokurim i paisjeve kompjuterike,
- prokurim i karrigeve,
- prokurim në grup i letrës për printim dhe kopjim i formati A4 (210X297) 80 gram, e bardhë,
- prokurim i lëndës djegëse të veturës së gjyqit,
- prokurim i materialeve për zyra,
- rikonstruim i hapsirës së punës,
- prokurim i materialeve për zyra,
- prokurim i sistemit inverter për ftohje dhe ngrohje.

KRYETARI I GJYKATËS SË APELIT GOSTIVAR

Shefajet Hajdari